



Europeanët presin një të ardhme më të zymtë
Serbia i ofron Malit të Zi përkthime të "Acquis" të BE-së
Europa pushon, SHBA punon! Një dallim që po thellohet gjithnjë e më shumë


EUROSPEAK

Buletin i Lëvizjes Europiane në Shqipëri

Nr. 17 Qershor - Korrik 2013

Speciale

**Zgjedhjet e përgjithshme të 23 qershorit në retrospektivë:
Prurjet e reja, shanset për reformimin e partisë humbëse dhe roli i medias**



Edhe pse u pritën me ankthin e përsëritjes së parregullsive, zgjedhjet e përgjithshme të 23 qershorit, të cilësuar si një moment kyç për të ardhmen europiane të Shqipërisë, në të vërtetë u zhvilluan përgjithësisht në mënyrë të ndershme dhe në përputhje me standardet e pritura nga misioni vëzhgues i OSBE/ODIHR-it. Shumë analistë bien dakord se diferenca e thellë e rezultatit përjashtoi që në fazat e para të numërimit çdo mundësi manipulimi, duke i dhuruar Shqipërisë atë që mund të vlerësohet si procesi zgjedhor më cilësor i mbajtur vitet e fundit. Tashmë që debatet për KQZ-në e paplotë sa i takon anëtarësisë së saj apo shqetësimet për manipulime mund të lihen

...vijon në faqen 2 >>

Për mirë, për keq: Bashkimi European merr Kroacinë si anëtarin e tij të 28-të



Më 1 korrik 2013, pas një angazhimi rraskapitës Kroacia iu bashkua BE-së, duke shënuar kështu anëtarësimin më të ri, që nga zgjerimi i fundit, hyrja e Bullgarisë dhe Rumanisë në vitin 2007. Por si do të ndikojë ky anëtarësim tek BE-ja, e cila ndodhet në krizë ekonomike dhe

politike? Po tek vendet e tjera që aspirojnë të anëtarësohen? EuroSpeak sjell ekstrakte nga analiza e mprehtë e European Policy Centre.

...vijon në faqen 5 >>

**Roli i komunitetit
ndërkombëtar në
Shqipëri në kohë
zgjedhjesh dhe më tej**



*Intervistë me Besa Shahinin,
analiste e Iniciativës
Europiane për Stabilitet*

EuroSpeak: Zakonisht, Shqipëria shihet si një vend ku komuniteti ndërkombëtar ka ndikim të konsiderueshëm. Megjithatë, vitet e fundit vërehet një qëndrim step in – step out, pra ata herë përfshihen aktivisht në agjendën kombëtare, e herë qëndrojnë dëshmitarë pasivë të ngjarjeve. A e ndani këtë mendim? Perse mendoni se ndodh kështu?

Besa Shahini: Është e çuditshme në fakt përfshirja e komunitetit ndërkombëtar në Shqipëri. Në asnjë vend tjetër në rajon – përveç Kosovës e Bosnjës, që kanë qenë të qeverisura nga komuniteti ndërkombëtar për disa

...vijon në faqen 4 >>

Zgjedhjet e përgjithshme të 23 qershorit në retrospektivë: Prurjet e reja, shanset për reformimin e partisë humbëse dhe roli i medias.

...vijon nga faqja 1 >>

mënjë, EuroSpeak vë në fokus aspekte të tjera të rëndësishme në këto zgjedhje. Përse kësaj here vërejmë më pak prurje të reja në politikë? A mund të konsiderohet realisht e dëmtuar liria e medias pas vendimit të KQZ-së lidhur me pranimin e materialeve zgjedhore të përgatitura nga partitë? Dhe së fundmi, sa realiste janë sot shanset për reformimin e partisë humbëse? Pikëpamjet e Prof. Dr. Artan Fugës dhe Lektorit të UT, Blendi Ceka të shprehura vetëm pak ditë përpara mbajtjes së zgjedhjeve, na orientojnë në eksplorimin e këtyre dritëhijeve të zgjedhjeve të përgjithshme.

Prurjet e reja në politikë

EuroSpeak: Ajo që vërehet këtë vit në listat e kandidatëve për deputetë të partive kryesore, por dhe në debatet televizive është më pak fokus tek prurjet e reja. Një ndryshim i dukshëm me qasjen e PD-së dhe Komitetit për Orientimin e Politikave (KOP) në vitin 2005 apo së PS-së në vitin 2009, ku gjatë fushatës i mëshohej idesë së përfshirjes

vendit. Në gjykimin tuaj, përse është lënë mënjë “motoja e prurjeve të reja” ndërkohë që sondazhe të ndryshme tregojnë një lodhje të elektoratit me elitat e partive? A ndikon kjo në mundësitë e reformimit brenda partive dhe si?



Blendi Ceka: Lloji i sistemit zgjedhor ndikon drejtpërdrejt në mënyrën e të bërit fushatë elektorale. Proporcional rajonali me lista të mbyllura dikton një fushatë zgjedhore të bazuar

kanë një peshë shumë më të vogël sesa në rastet e sistemeve të familjes maxhoritare. Këtë parim teorik duket se e zbatuan mirë në këto zgjedhje dy partitë e mëdha. Gara e tyre bazohet në programe dhe duket se është përgjegjësia e liderëve të partive t'i

artikulojnë dhe shpjegojnë alternativat e tyre para qytetarëve. Kandidatët në lista janë ekipe që bartin dhe garantojnë programin, ndërkohë që tiparet dhe cilësitë e tyre vijnë si vlerë e shtuar përpara publikut. Rëndësia e kandidatëve në rastin e partive të mëdha është për pjesën e diskutueshme të listës. Në këto raste, duket se partitë kanë zgjedhur të vendosin në lista kandidatë me lidhje dhe rrjete të forta lokale me qëllim maksimizimin e votave dhe rezultatit në çdo qark. Partitë janë agjentë racionalë që synojnë maksimizimin e votave dhe marrjen e pushtetit. Në këtë kuadër, bazuar dhe në eksperiencat e mëparshme, të rinjtë e arsimuar duket se nuk e përmbushin këtë pritshmëri.

Ndërkohë që për partitë e tjera duket se kjo marrëdhënie është e përmbysur. Në këto raste, si pasojë e pritshmërive realiste roli i kandidatëve të parë në lista është shumë më i rëndësishëm sesa

kandidatëve është një kombinim i personave shumë publik (si ish-ministra në rastin e LSI) me

konsiderueshme.

Reformimi i partisë humbëse, i diktuar nga vetë vullneti i liderit

EuroSpeak: A është me vend të hamendësohet se avantazhi i këtyre zgjedhjeve në çdo rast do të jetë reformimi i pashmangshëm partisë kryesore humbëse [tashmë Partia Demokratike]? Sipas jush, cilët janë skenarët më realistë? Si dhe kur do të reformohen partitë kryesore në Shqipëri?

Blendi Ceka: Kjo është e vështirë të thuhet. Për herë të parë pas tetë vitesh, në parlamentin e ardhshëm të dy liderët e partive të mëdha do të jenë

pjesë e parlamentit. Ata janë personat përgjegjës për hartimin e listave dhe gëzojnë autoritetin maksimal në grupet e pritshme parlamentare. Më shumë sesa pasojë e rezultatit apo statuteve të partive, qëndrimi ose jo i këtyre liderëve (bazuar dhe në eksperiencat e shkuara) në krye të partive të tyre edhe pas humbjes, varet nga vullneti i tyre personal. Në këtë kontekst, reformimi i pritshëm i partive jo domosdoshmërisht varet nga fati dhe rezultati i zgjedhjeve. Edhe nëse ndodh, kjo i duhet atribuar vullnetit personal të liderëve dhe jo presionit të brendshëm “demokratik” partiak apo shoqëror.



Foto: National Democratic Institute

Çdo hapësirë, edhe një sallon bukurie, mund të përshtatet për fushatë elektorale.

Liria dhe roli i medias në fushatë

Në 3 qershor KQZ mori një vendim të diskutueshëm dhe të paqartë ku udhëzoi Bordin e Monitorimit të Medias (BMM), për përdorimin nga transmetuesit publikë dhe privatë në edicionet e lajmeve të materialeve të prodhuara nga partitë politike. Vendimi u bë objekt kundërshtish të forta nga ana e Avokatit të Popullit dhe Unionit të gazetarëve.

në mbulimin e fushatës elektorale? Më poshtë, qëndrimet e Prof. Dr. Artan Fugës mbi këtë çështje.

EuroSpeak: Gjatë fushatës elektorale, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mori një vendim me katër anëtarë mbi pranimin e kasetave të materialeve zgjedhore të partive nga ana e televizioneve, vendim i cili është kritikuar nga Unioni i Gazetarëve dhe Avokati i Popullit. Cili është qëndrimi juaj lidhur me këtë çështje dhe si ju është dukur roli i medias në fushatë në përgjithësi?



Artan Fuga: Në mendimin tim kjo çështje nuk lidhet fare as me Komisionin Qendror Zgjedhor dhe aq më pak me Avokatin e Popullit

që më kot ngatërrohet me atë punë. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nëpërmjet mekanizmave të tij mund të shohë sesi respektohet shpërndarja e kohës së transmetimeve në mediat audiovizuale, ndonëse edhe për këtë problem është shumë relativ. Një media mund të transmetojë një çerek ore për një parti dhe të mos thotë asgjë, dhe mund të transmetojë vetëm dhjetë sekonda nga aktivitetet e një partie tjetër dhe të thotë shumë.

Kjo nuk do të thotë që koha nuk ka rol, por vetëm se duhet gjykuar shumë më gjerë dhe për këtë duhen kriteret që janë krejtësisht të papërpunuar. Nëse një medie i pranon informacionet e ardhura nga zyrat e marrëdhënieve publike të partive politike ose jo, kjo varet nga vetë media. Nga njëra anë nuk ka përse të mos i pranojë. Është një praktikë shumë e njohur e “media broadcasting release” kur agjenci të ndryshme i përgatisin vetë informacionet video dhe ia dërgojnë mediave audiovizive të gatshme. Ka procedura për këto. Paguhet, shoqërohet me tekst të shkruar, bëhet si kontratë marketingu, etj. është një formë informacioni e kontrolluar nga zyrat e marrëdhënieve publike. Nuk ka absolutisht të keqe. Por, asgjë fare. Me kusht ama: Duhet që të mos transmetohet në emisionin informativ sepse në këtë rast ngatërrohet marketingu me informacionin në mënyrë të qëllimshme, institucionale dhe ka për qëllim mashtrimin e publikut. E dyta, duhet që

vjen e përgatitur nga vetë partitë politike. E treta, që kjo praktikë nuk duhet të pengojë apo ezaurojë raportimet nga gazetarët. Përndryshe, po qe se nuk realizohen minimumi këto kushte, veç anës profesionale, kemi të bëjmë me një kundravajtje civile, sipas juridiksionit demokratik të sotëm, së paku me një amoralitet mediatik, me rastin kur media mashtron publikun, audiencat, dhe e shet reklamën për informacion. Brenda kushteve që përmenda, nuk ka asnjë problem, si nuk ka problem kur bëhet reklama e ndonjë fshese me korrent, e të brendshmeve të modës, apo e çdo malli tjetër që shitet dhe blihet.

Efekti post 23 qershor...

Çlirimi nga frika e manipulimeve të mundshme dhe bllokimi procedural për shkak të KQZ-së së paplotë vërtetoi sërish masën në të cilën mbarëvajtja e proceseve me rëndësi në Shqipëri varet drejtpërdrejt nga aktorët politikë. Në këtë rast, partitë politike nëpërmjet sjelljes përgjithësisht korrekte (veçanërisht gjatë numërimit të votave), treguan se mbarëvajtja e zgjedhjeve varej nga vullneti i tyre për të lejuar apo mundësuar zgjedhje të lira e të ndershme, më shumë sesa nga institucionet përgjegjëse apo roli i ndërkombëtarëve.

ndihen efektet e para pozitive të mbajtjes së tyre përgjithësisht brenda normave ndërkombëtare. Tashmë Shqipëria është më afër marrjes së statusit kandidat në fund të vitit.

të OSBE/ODIHR, **Conny McCormack**, duke vlerësuar procesin zgjedhor në Shqipëri deklaroi se me të u tregua pjekuria e demokracisë në vend. Ajo nënvizoi vullnetin dhe gatishmërinë e çdo aktori për bashkëpunim gjatë procesit zgjedhor, si dhe vlerësoi lart klimën e shkëlqyer në të cilën misioni operoi.

Zëvendësndihmës Sekretari amerikan të Shtetit, **Philip Reeker** në emër të Shteteve të Bashkuara të Amerikës i ka konsideruar zgjedhjet e 23 Qershorit si më të mirat në historinë e pluralizmit në Shqipëri, duke i dhënë kështu legjitimitet të plotë mazhorancës së re që prodhuan këto zgjedhje. Pas presioneve të forta ndaj qeverisë për të mos prekur votën e shqiptarëve, Uashingtoni ka shprehur vlerësim maksimal për zgjedhjet.

Ambasadori i BE-së, Ettore Sequi deklaroi se statusi i vendit kandidat për Shqipërinë është i arritshëm në muajin dhjetor. Duke vlerësuar zgjedhjet e 23 qershorit, Sequi apeloi për një tranzicion sa më të butë të pushtetit dhe theksoi se kompromisi duhet të jetë pjesë e jetës politike shqiptare.

për misionin e vëzhgimit të ODIHR-it. Zgjedhjet ishin konkurruese, fatkeqësisht pati një rast dhune, por procesi i votimit u zhvillua në mënyrë krejt të rregullt. Çfarë merr rëndësi tani për ne lidhet

me përmbylljen e procesit dhe tranzicionit në një mënyrë të butë”, - tha Sequi në një deklaratë të tij. Ambasadori Sequi nënvijëzon faktin se pritshmëria për qeverinë e re është nevoja për të vijuar reformat e nevojshme për integrimin evropian.

Në një deklaratë të përbashkët të përfaqësueses së lartë **Catherine Ashton** si dhe komisionerit **Štefan Füle**, i përgëzuan qytetarët shqiptarë për zgjedhjet e lira dhe procesin e rregullt zgjedhor në këto zgjedhje parlamentare në Shqipëri.

Stafi i EuroSpeak, qershor 2013

Roli i komunitetit ndërkombëtar në Shqipëri në kohë zgjedhjesh dhe më tej

...vijon nga faqja 1 >>

vite pas luftërave – nuk i sheh përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar më shumë nëpër gazeta e televizione. Qëndrimet dhe mendimet e tyre mbi ngjarjet e përditshme politike në Shqipëri zënë hapësirë veçanërisht të madhe në diskursin politik vendor. Por kjo hapësirë mediatike nuk është ekuivalente me ndikimin real të komunitetit ndërkombëtar.

Komuniteti ndërkombëtar ka ndikim në politikën shqiptare për aq sa ka “karota” apo “shkopinj” për Shqipërinë. Për shembull, SHBA-të kanë pasur një ndikim më të madh para anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, kur në shkëmbim të anëtarësimit ata

politike të ambasadorëve të SHBA-ve në Tiranë nga aktorët politikë në Shqipëri.

BE-ja është ndryshe. Shqipëria synon të anëtarësohet në BE, kështu që ajo mund të kishte shumë më shumë ndikim. Por mesazhet që dërgohen nga Brukseli nuk janë gjithmonë të qarta dhe të fuqishme. Kjo u pa edhe gjatë përgatitjeve për zgjedhjet parlamentare 2013, kur BE-ja ishte mjaft e shqetësuar mbi zhvillimet në lidhje me KQZ-ne, por nuk dha ndonjë deklaratë të fuqishme për atë çështje. Zyrtarët e ndryshëm evropianë u benë thirrje palëve kryesore politike që të gjejnë një zgjidhje politike për KQZ-në. Por në fakt, ata do të duhej t'i kërkonin parlamentit ndryshimin

e vendimit mbi largimin e jashtligjshëm të një anëtari të KQZ-së. Kjo lloj ambivalence lë shumë për tu interpretuar dhe nuk pati efektin e duhur. Shqipëria shkoi në zgjedhje me një KQZ me katër anëtar, që nuk frymëzoi besim se gjithçka do të shkonte si duhet.

EuroSpeak: Është folur shumë për një kthesë në qëndrimin e SHBA-ve mbi zgjedhjet, veçanërisht pas vizitës së dytë të Z. Moore. Është komentuar se nëse më herët SHBA-të vinin theksin tek mbajtja e zgjedhjeve të lira e të ndershme, në respekt të standardeve ndërkombëtare, tashmë theksi vihet tek mos-protestimi dhe ruajtja e qetësisë pas rezultatit, pra sido që të menaxhohet procesi zgjedhor. A ka pasur realisht një kthesë në gjykimin tuaj? Nëse po, si mendoni se ka ndikuar tek fushata elektorale?

Besa Shahini: Nuk e shoh si kthesë në qëndrime. E shoh më shume si një moment kur zyrtarët

politika shqiptare. Fillimisht ata mbajtën një qëndrim parimor për respektimin e standardeve ndërkombëtare të zgjedhjeve, që do ta parandalonte ndonjë krizë të mundshme pas zgjedhjeve si pasojë e kontestimit të mundshëm të rezultatit. Z. Arvizu foli qartë dhe fuqishëm edhe ditën kur parlamenti votonte heqjen e një anëtari të KQZ-së. Por kur

SHBA-ve të thotë ishte që në qofte se ka kontestim dhe protesta, së paku të mos ketë dhunë.

EuroSpeak: Shqiptarët shquhen për adhurim në masë të autoritetit të huaj dhe pritshmëri më të larta ndaj tij se sa nga vetë institucionet e vendit. Si do ta komentoni këtë fakt, edhe nën dritën e qëndrimeve të BE-së dhe SHBA-ve para zgjedhjeve?

Besa Shahini: Kam përshtypjen se bashkësia ndërkombëtare ka hequr dorë nga ideja se në Shqipëri mund të mbizotërojë rendi e ligji dhe se mund të krijohen institucione të qëndrueshme demokratike. **Marrëveshjet politike qëndrojnë mbi ligjin dhe mbi institucionet**, dhe bashkësia ndërkombëtare duket se e ka pranuar këtë si fakt të pandryshueshëm. Si rezultat, ekziston një pritshmëri që problemet politike do të zgjidhen vetëm me marrëveshje politike, kështu që bashkësia

ndërkombëtare gjatë krizave vazhdimisht bën thirrje për “vullnet politik.”

Kjo nuk i ndihmon vendit dhe është pikërisht ky qëndrim që e zhgënjën popullin shqiptar. Nuk ka asnjë arsye pse Shqipëria të mos jetë në gjendje të krijojë institucione demokratike që mund të qëndrojnë mbi politikën ditore. Procesi i integritetit në BE ka qenë instrumental për Kroacinë në ndërtimin e institucioneve të qëndrueshme pas luftës. Vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor kanë arritur një gjë të tillë gjithashtu – edhe Shqipëria mundet.

Stafi i EuroSpeak, korrik 2013

Për mirë, për keq: Bashkimi European merr Kroacinë si anëtarin e tij të 28-të

...vijon nga faqja 1 >>

Mirë se vini në Perëndimin e egër!



Perspektiva e prosperitetit dhe stabilitetit brenda BE-së sigurisht që do të mbetet, por është pa dyshim më pak e dukshme për momentin sesa kur Kroacia përqafoi rrugën e anëtarësimit në BE në vitin 2003. Logjika e “çfarë është e imja është dhe e jotja” vlen edhe në kohët e vështira: Problemet e BE-së tani janë probleme të Kroacisë (dhe anasjelltas).

Të shqetësuar me krizën dhe të pasigurt për të ardhmen, shtetet anëtare të BE-së nuk janë të entuziazmuar rreth hyrjes së Kroacisë. Migrena e pranimit të Bullgarisë dhe Rumanisë kanë shtuar më tej pasiguritë e këtij rrethi të zgjerimit. Nga ana tjetër, përkrahësit e zgjerimit janë të etur për të shfaqur hyrjen e Kroacisë si dëshmi se BE-ja mund

të ushtrojë ende një ndikim transformues mbi entuziastët e Europës së Bashkuar, dhe si një hap përpara në konsolidimin e paqes dhe stabilitetit në

Prania e kushtëzimit duket në anëtarësim

Me një normë të rritjes ekonomike në fundosje,

rezultoi nga një anketim i kohëve të fundit i Ernst & Young si vendi i dytë më i korruptuar në Europë. Pra pyetja nëse Kroacia do të shtojë problemet e BE-së është aq e rëndësishme sa dhe nëse vendi do të jetë në gjendje të përdorë anëtarësimin për hir të rimëkëmbjes, duke thithur miliarda euro fonde, të dedikuara për zhvillimin e saj të pas aderimit.

Rruga e Kroacisë për tu larguar nga lufta dhe drejtuar për në BE-së ka qenë e ashpër. Para se të pranohet në Bashkim, Kroacia duhej të rindëronte institucionet e saj të pas luftës, të gjente të arratisurit kyç të akuzuar për krime lufte, të nxiste një kulturë të sundimit të ligjit, të frenonte nivelin e lartë të korrupsionit dhe krimin të organizuar, të

zgjidhte çështje të mprehta dypalëshe me vendet fqinje.

Rreziku më i madh për Kroacinë tanimë është lodhja nga transformimi. Puna bëhet dhe më e madhe pa mbështetjen popullore. Kroatët kanë treguar shkëputjen e tyre me axhendën e BE-së mjaft qartë në sondazhet e opinionit të përsëritura për integrimin. Pjesëmarrja në referendumin e për aderimin e vendit në BE ishte vetëm 43% dhe ajo në zgjedhjet e para për Parlamentin Europian edhe më ulët, vetëm 21%!

Kroacia dhe e ardhmja e zgjerimit të BE-së

E ardhmja e zgjerimit në Ballkan mbështetet pjesërisht mbi shpatullat e Kroacisë. Pranimi i vendit mund të sjellë frymë të re në politikën e zgjerimit të BE-së, dhe mund të motivojë edhe fqinjët e saj - të cilët si Kroacia, aspirojnë për anëtarësim që të përshpejtojnë reformat dhe përpjekjet e tyre transformuese.

Kroacia nuk mund të ndihmojë shumë për të përmirësuar problemin e imazhit të rajonit në

BE. Por në qoftë se ajo i thyen rregullat e 'klubit', aspirantët e mbetur në Ballkan përballen me marginalizim afatgjatë. Kjo mund t'i jepte lajmin e keq demokracive të reja e të brishta të Ballkanit dhe të minonte investimin e madh të bërë tashmë nga BE-ja në rajon.

Roli që Kroacia merr në rajon mund të pengojë ose të lehtësojë rrugën e vendeve të tjera të Ballkanit drejt Bashkimit europian. Për momentin, hyrja e Kroacisë e siguron pjesën tjetër të Ballkanit se përpjekjet për reforma të vërteta hapin dyert e anëtarësimit, duke rritur angazhimin e tyre në procesin e integritit. Por, sipas EPC mundësia e mosmarrëveshjeve që lindin mes Kroacisë dhe fqinjëve të saj ballkanikë nuk mund të përjashtohet, edhe në qoftë se Kroacia ka zgjidhur problemet e veta bilaterale gjatë vitit të kaluar, sidomos me Bosnjë-Hercegovinën.

European Policy Centre, qershor 2013

Kartolina nga BE-ja

Akuzat e spiunazhit Tensionohen marrëdhëniet SHBA - BE

rrjetet lokale të BE-së ka nxitur marrjen e masave të shpejta nga Komisioni Europian. José Manuel Barroso, presidenti i Komisionit Europian, ka urdhëruar kontrollimin e sigurisë së zyrave të Komisionit në vazhden e akuzave që inteligjenca amerikane ka spiunuar në institucionet e Bashkimit Europian në SHBA dhe në Bruksel.



Gazeta gjermane Der Spiegel pohoi se Agjencia Kombëtare e Sigurimit (NSA), shërbimi kryesor i SHBA-ve që ka të bëjë me mbikëqyrjen e komunikimit, kishte fshehur pajisje dëgjimi brenda ambienteve të BE-së në Uashington, DC,

komunikimit. Akuza u bë mbi bazën e dokumenteve që datojnë në vitin 2010 të mbajtur nga Edward Snowden, një ish-kontraktor për NSA i cili u largua në Hong Kong në maj dhe tani besohet të jetë në Moskë. Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin u shpreh se: “Nëse ai dëshiron të shkojë diku dhe dikush do ta marrë atë, le ta bëjë. Në qoftë se ai dëshiron të qëndrojë këtu, ka një kusht - ai duhet të ndalë punën e tij që synon dëmtimin e partnerit tonë Amerikan, edhe pse tingëllon çuditshëm e dalë nga goja ime.

Gjermania, e shokuar nga raportet se inteligjenca amerikane ka spiunuar institucionet e BE-së, është shprehur “Europa dhe SHBA-të janë partnere, miq dhe aleatë. Besimi duhet të ekzistojë në bazë të bashkëpunimit. Kjo nuk është më Lufta e Ftohtë. Por nëse është e vërtetë se institucionet e BE-së dhe shtete anëtare janë spiunuar, ne duhet të themi se përgjimi i miqve është i papranueshëm.”

Marrëveshja tregtare në rrezik

Përfaqësuesja e Lartë e BE-së Catherine Ashton dhe Komisionerja Europiane e Drejtësisë Viviane Reding kanë paralajmëruar se akuzat mund të rrezikojnë bisedimet mbi një marrëveshje tregtare të ardhshme midis SHBA-ve dhe BE-së, të nisura zyrtarisht muajin e kaluar.

Sekretari i shtetit SHBA John Kerry ka premtuar se akuzat do analizohen më tej, por u shpreh se “nuk ishte i pazakontë”, kërkitimi i informacionit mbi vendet e tjera. Sipas tij çdo vend në botë që është i angazhuar në çështjet ndërkombëtare, apo të sigurisë kombëtare ndërmerr shumë aktivitete për të mbrojtur sigurinë e tij kombëtare dhe të gjitha llojet e informacionit kontribuojnë për këtë.

nga akuzat e spiunazhit në rritje në hapësirën transatlantike, pasi Gjermania dhe Franca denoncuan veprimtaritë kryesore të agjencive amerikane dhe paralajmëruan për një shtyrje

bisedimeve ambicioze për tregtinë e lirë ndërmjet Europës dhe SHBA.

Kancelarja gjermane, Angela Merkel, dhe presidenti francez, François Holandë, kërkuan shpjegime të

menjëhershme nga Uashingtoni për informacionet e publikuara nga Guardian dhe Der Spiegel se agjencitë amerikane kanë përgjuar ambasadat europiane dhe zyrat.

“Ne nuk mund të pranojmë këtë lloj sjelljeje mes partnerësh dhe aleatësh” - tha ai. “Ne kërkojmë që kjo të ndalohej menjëherë. Nuk mund të ketë negociata ose transaksione në të gjitha fushat derisa të kemi garanci për të gjithë vendet e Bashkimit Europian. Ne e dimë mirë se ka sisteme të cilat duhet të kontrollohen, sidomos për të luftuar terrorizmin, por unë nuk mendoj se ky kërcënim ekziston në ambasadat tona apo në Bashkimin Europian.”

Ndërkohë, Obama u përpoq të ulë tensionin mes një zemërimi në rritje në Europë, duke u shprehur se agjencitë amerikane janë sjellë si çdo organizatë tjetër inteligjence në botë. “Jo vetëm e jona, por çdo shërbim europian inteligjence, çdo shërbim aziatik inteligjence, kudo që ekziston një shërbim inteligjence – ekziston një gjë që ata duhet të bëjnë: ata do të përpiqen të kuptojnë botën më mirë dhe se çfarë po ndodh në kryeqytete të botës” tha presidenti i SHBA-ve. Obama kërkoi të risigurojë liderët e tjerë botërorë se shkalla e spiunazhit amerikan kundër vendeve mike nuk nënkupton mungesën e besimit.

Stafi i EuroSpeak, korrik 2013

Francezët dhe gjermanët ndajnë gjithnjë e më pak pikëpamje të njëjta

Përppjekjet e gjysmë shekulli për të krijuar një

pas here nga dyshimi në rritje në shumë vende anëtare mbi projektin europian.

Së bashku, Franca dhe Gjermania janë etërit themelues të Bashkimit Europian dhe të dy ekonomive më të mëdha në Eurozonë. Por në vitet e fundit, divergjencat e tyre ekonomike i kanë ndarë ata edhe politikisht. Të dhënat për

të madh tregtar, ndërkohë që Gjermania gëzon një pozitë më të mirë.

Një studim i realizuar nga Qendra Pew Research në maj zbuloi se qëndrimet franceze për një grup

të gjerë çështjesh nuk ishin më në një mendje me ato të gjermane. Në vitin 2007, 68% e gjermanëve dhe 62% e francezëve ishin në favor të BE-së. Sot shifra gjermane ka rënë në 60%, dhe ajo franceze është në rënie të lirë: vetëm 41% janë tani në favor të BE-së, duke u renditur menjëherë pas Greqisë dhe Republikës Çeke për nivelin e euroskepticizmit.

Rritja e zhgënjimit ndaj Europës së bashkuar nuk është e vetmja pikë e divergjencave franko-gjermane. Francezët janë shumë më të zymtë se sa fqinjët e tyre të vendosur përgjatë gjithë lumit Ren. Nëse 57% e gjermanëve mendojnë se vendi i tyre po shkon në drejtimin e duhur, vetëm 19% e francezëve mendojnë kështu. Vetëm 9% e francezëve besojnë se kushtet e tyre ekonomike janë të mira, krahasuar me 75% të gjermanëve. Në këtë aspekt, Franca është më tepër në një linjë me Spanjën (4%), Italinë (3%) dhe Greqinë (1%). Plot 80% e francezëve janë të shqetësuar në lidhje me punën, kundrejt vetëm 28% e gjermanëve. Studimi i Pew Research evidentoi se, “humori publik francez tani është duke ngjarë më pak me atë Gjerman dhe më shumë me kombet jugore të Spanjës, Italisë dhe Greqisë”.

Sondazhi i kryer nga Qendra Pew Research vjen me të dhëna interesante edhe mbi atë se çfarë mendojnë europianët për njëri-tjetrin. Gjermanët, me rolin e tyre dominues në menaxhimin e krizës në Eurozonë, kanë pështjelluar emocione të përziera tek europianët për bashkëqytetarët e tyre. Në çdo vend anëtar, përveç Greqisë, njerëzit i konsiderojnë gjermanët më të besueshmit. Në të njëjtën kohë, në gjashtë prej tetë vendeve të anketuara, njerëzit i shohin gjermanët si më pak të mëshirshmit. Ndërkohë që në pesë nga tetë vendet e anketuara, ata janë konsideruar si më arrogantët. Në vazhden e masave të rrepta të kursimit të imponuara nga Gjermania në Greqi, armiqësia greke kundrejt gjermanëve duket se kushton jo pak. Grekët i konsiderojnë gjermanët si më pak të besueshmit, më arrogantët dhe më pak të mëshirshmit. Por edhe grekët vetë, nuk kanë performancë të mirë. Ata janë konsideruar më pak të besueshmit nga francezët, gjermanët dhe çekët.

Stafi i Euro Speak, qershor 2013

Letonia, anëtarja e 18-të e eurozonës në 2014

Përtej skepticizmit tejet të përhapur mbi të ardhmen e euros, Letonia - e cila aderoi në Bashkimin Europian në vitin 2004 - do të bëhet shumë shpejt pjesë e eurozonës. Në qershor 2013 Komisioni Europian sinjalizoi dritën e gjelbër për këtë proces. Megjithatë, sondazhi më i fundit i opinionit publik tregoi se vetëm 36% e letonezëve favorizuan ndryshimin e monedhës, ndërsa 62% ishin kundër.



Ndërkohë, raporti i Brukselit tha se vendi prej dy milionë banorësh ka plotësuar kënaqshëm kushtet ekonomike për tu bashkuar me Eurozonën, si rezultat

publike. Gjithashtu, legjislacioni kombëtar i Letonisë është në përputhje me rregullat e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (EMU).

të vitit 2014, pas përmbushjes së kriterëve për

afatgjatë të interesit, si dhe borxhin e ulët publik. Komisioneri i Çështjeve Ekonomike dhe Monetare të BE-së Olli Rehn u shpreh se ata që parashikuan shpërbërjen e euros u gabuan. “Dëshira e Letonisë të adoptojë euron ishte një shenjë e besimit në monedhën e vetme” - shtoi ai. Ai vuri në dukje që në shumë vende të Europës Lindore ka një entuziazëm të përhapur për bashkimin me monedhën e vetme. Megjithatë, sondazhet sugjerojnë se shumë në vend janë të shqetësuar që ndryshimi mund të rrisë çmimet.

Letonia iu nënshtrua një prej programeve më të vështira të kursimit në Europë. Mori një asistencë

i ka shlyer kreditë.

Anëtarësimi ende duhet të miratohet nga udhëheqësit e BE-së dhe Parlamenti Europian, por kjo është parë

të nënshkruajnë hyrjen në korrik. Banka Qendrore Europiane (ECB), i dha bekimin e saj Letonisë përpara shpalljes së Komisionit, por paralajmëroi që depozitat e larta të huaja në bankat e saj ishin një

BBC, qershor 2013

Raporti 2012 i Ombudsman-it Europian, numër rekord rastesh

Ombudsman-i (Avokati i Popullit) Europian heton ankesat në lidhje me keqadministrime në institucionet e BE-së, organet, zyrat dhe agjencitë. Çdo qytetar i BE-së, ndërmarrje ose shoqatë e një shteti anëtar mund të paraqesë një ankesë pranë Avokatit të Popullit. Viti 2012 ishte një vit veçanërisht intensiv për Avokatin e Popullit dhe

e të mbyllura. Hetimet e hapura (465) përbëjnë një rritje prej 18% krahasuar me 2011 (396). Avokati i Popullit ka regjistruar 2 442 ankesa në vitin 2012, nga të cilat 740 ishin brenda tagrit të tij. Kjo krahasohet me 2 510 ankesave në vitin 2011, nga të cilat 698 ishin brenda tagrit.

Në mbi 75% të rasteve (1 854), Avokati ishte në gjendje të ndihmonte ankuesin me hapjen e një hetimi, transferimin e rastit te një organ ose këshillimin e ankuesin se ku të drejtohet. Në 43% të rasteve, ai inkurajoi ankuesit të kontaktonin organet e tjera, përfshirë SOLVIT. Në 89 raste të mbyllura në vitin 2012, u arritën rezultate pozitive, pra institucionet përkatëse zgjidhën çështjen, u pajtuan për një zgjidhje miqësore, ose pranuan një draft rekomandim.

Meqë Komisioni Europian është institucioni kryesor që ndërmerr vendime që kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi qytetarët, është normale që ai të jetë objekt kryesor i ankesave. Një rast konkret ishte kur Komisioni ra dakord të rimbursojë mbi 100 000 euro një OJQ-je, në përgjigje të pretendimeve se kishte shkelur parimin e pritjeve legjitime duke dështuar në respektimin e metodologjisë për raportimin dhe kostot e rena dakord reciprokisht mbi të.

Shtetet që listohen me numrin më të madh të ankesave (shprehur kjo me % e përgjithshme të ankesave të çdo shteti në lidhje me numrin e popullsisë së shteteve të BE-së) janë Gjermania, Britania e Madhe, Italia e Rumania. Ndërkohë që vendet me ankesa më të pakta të drejtuara tek Avokati i Popullit janë Irlanda dhe Belgjika.

Stafi i EuroSpeak, korrik 2013

Lituanian merr presidencën e Këshillit të BE-së



Viti 2013 është një vit i veçantë për Lituaninë: për herë të parë ka mundësinë të marrë presidencën e Këshillit të Bashkimit Europian. Çdo 6 muaj, një shtet anëtar i BE-së ka përgjegjësinë e presidencës së Këshillit. Më 1 korrik,


Lituanisë iu dorëzua me rotacion presidenca nga Irlanda. Ajo do ta mbajë atë gjer në Janar të 2014, kur presidenca t'i kalojë Greqisë. Çdo presidencë synon të mirë-menaxhojë Këshillin dhe të përmbushë funksionet e përshkruara në traktate. Raimundas Karoblis, Ambasador dhe Përfaqësues i Përhershëm i Lituanisë në BE tha se prioritetet e Lituanisë mbështeten në tre shtylla:

Rritja ekonomike dhe punësimi: implementimi i

Dixhitale, tregun e brendshëm të energjisë, dhe

Samiti i Partneritetit Lindor në nëntor në Vilnius do të përqendrohet në nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA) dhe Marrëveshjes të Thellë e Gjithë-përfshirëse të Tregtisë së Lirë (DCFTA) me Ukrainën. "Interesi jonë i përbashkët dhe i Europës është të afrojmë vendet fqinje me vlerat europiane, prandaj ne duam të fokusohemi në marrëdhëniet me Moldavinë, Armeninë dhe Gjeorgjinë" - përfundoi Karoblis.

Stafi i EuroSpeak, korrik 2013



pensioneve, ku 33 % prisnin një punë më të kënaqshme se prindërit e tyre dhe 22 % shpresonin në një pension më të mirë. Shumica e të anketuarve polakë presin gjithashtu që të jetojnë më gjatë dhe me një shëndet më të mirë se sa prindërit e tyre, dhe të kryejnë më shumë aktivitete në kohën e tyre të lirë.

Në të kundërt, francezët, spanjollët dhe italianët rezultuan më pesimistë në lidhje me të ardhmen e tyre ekonomike, ku shumica pret të luftojë për të gjetur një punë të paguar mirë dhe një pension.




Shifrat tregojnë një reduktim të mprehtë në numrin e europianëve të cilët e shohin të ardhmen e tyre me pozitivitet. Një studim i ngjashëm i Gallup-it në vitin 2011 gjeti se shumica e europianëve kishin më shumë besim për të ardhmen e tyre, pavarësisht rritjes së dobët ekonomike. Që atëherë, eurozona ka rënë përsëri në recesion dhe papunësia ka vazhduar të rritet. Mbi 20 % e europianëve të moshës 16-25 janë të papunë. Kjo është shifra më e lartë e regjistruar ndonjëherë në të gjithë Bashkimin Europian. Në Spanjë dhe Greqi, papunësia e të rinjve është në raportin një në dy

EU Observer, qershor 2013

Për të rinjtë thjesht nuk ka punë

Niveli mesatar i papunësisë së të rinjve në BE qëndron në 25%. Pasi u shokua nga shifrat e të rinjve të papunë në Afrikën e Veriut, Europa - duke përfshirë Finlandën - tani e gjen veten në një situatë të ngjashme. Në Europën Jugore papunësia e të rinjve qëndron në rreth 50 %, në BE në tërësi në

rreth 25% , dhe në Finlandë një e treta e atyre mes moshës 15 dhe 25 vjeçare janë të papunë. Papunësia e të rinjve është shkak i shumë shqetësimeve dhe po bëhen përpjekje në çdo nivel për ta ulur atë. Krerët e BE-së dhe qeverive kanë dhënë deri në 6 miliardë euro në Bruksel për të zvogëluar papunësinë e të rinjve.



dukej aq i mirë në letër sa u miratua nga vendet e tjera por nuk bëri asgjë për të përmirësuar situatën e të rinjve në tregun e punës. Thjesht, nuk ka punë.

Eurotopics, korrik 2013

Kina i kundërpërgjigjet BE-së pas tarifave ndaj paneleve diellore kineze

Kina nisi një hetim anti-damping dhe anti-subsencion për verën europiane në përgjigje të vendimit të Bashkimit Europian për të vendosur detyrime tarifore për importet e paneleve diellore kineze, duke rritur tensionet mes dy blloqeve të mëdha të botës tregtare. BE-ja imponoi detyrime tarifore për importet e paneleve diellore kineze më 6 qershor, por njoftoi një normë të reduktuar

presionit nga disa shtete anëtare të mëdha me shpresën e arritjes së një zgjidhjeje të negociuar me Pekinin. Ministria kineze e Tregtisë tha se detyrimet e BE-së janë të padrejta. Për më tepër ato u vendosën pavarësisht se Kina bëri përpjekje të mëdha dhe tregoi sinjeritet në përpjekjet për ta zgjidhur çështjen nëpërmjet bisedimeve. Ky hetim nisi si kërkesë e prodhuesve të verës kineze. Ministria kineze e Tregtisë mori një kërkesë nga



industria e verës familjare, ku akuzohej se vera e importuar nga Europa që hyn në tregun e Kinës nëpërmjet përdorimit të taktikave të padrejta tregtare duke aplikuar një çmim nën kosto. “Kjo ka pasoja direkte mbi industrinë tonë të verës, dhe

vendosjes së çmimit nën vlerën reale të produktit) dhe anti-subvencion,”- shtoi ministria. Qeveria Kineze deklaroi gjithashtu për nivelin në rritje të shpejtë të importit të verës nga BE-ja vitet e fundit, dhe se hetimi do të ndërmerrej në përputhje me ligjin. Sipas të dhënave të doganave kineze, Kina importoi 430 milion litra verë vitin e kaluar, nga të cilat më shumë se dy të tretat vinin nga BE-ja. Bashkimi Europian është partneri më i rëndësishëm tregtar i Kinës, ndërsa për BE-në, Kina është e dyta pas Shteteve të Bashkuara të Amerikës. BE-

kanë shitur nën kosto panelet diellore. Ndërkohë, Ministria kineze e Tregtisë i bëri thirrje BE-së për

për të hartuar një rezolutë ku të dyja palët mund të binin dakord nëpërmjet konsultimeve”.

Hurriyet Daily News, qershor 2013

Europa pushon, SHBA punon! Një dallim që sa vjen e thellohet

Aktualisht, numri mesatar i orëve të punës për person të moshës 15 deri në 25 çdo vit në Francë dhe Gjermani është rreth 50% më e ulët se sa në Shtetet e Bashkuara. Vende të tjera europiane (për shembull, Italia dhe Spanja) janë diku afër kësaj shifre. Edhe pse disa amerikanë gjithmonë pëlqejnë të mburren për etikën e tyre superiore të punës,

kjo pabarazi në orët e punës midis SHBA-ve dhe Europës nuk ka ekzistuar gjithmonë. Në të vërtetë, deri në mes të 1970, numri i orëve të punës në të dyja anët e Atlantikut ishte përafërsisht i njëjtë.

Nga mesi i 1970-ës, megjithatë, amerikanët vazhduan të punonin pak a shumë të njëjtin numër orësh,

gjithnjë e më pak çdo vit. Numri mesatar i orëve të punës së një personi varet nga një sërë faktorësh si

në një javë normale, etj.

Dallimi ndërmjet SHBA-ve në njërin anë dhe Francës dhe Gjermanisë në anën tjetër vjen si rezultat i dy faktorëve, secili me peshë afërsisht të barabartë. Rëndësia e kohës së pushimit nuk duhet të jetë befasi për këdo që ka përjetuar qytetet e shkretuara të Europës në gusht, tri javë pushime në prill dhe maj në Francë dhe Itali, “orët e pikut” që mbahet çdo të premte në 2 pasdreke në qytetet gjermane, dhe shpatet e skive të mbushur me njerëz në shkurt për shkak të pushimeve shkollore të dimrit.

Të kuptuarit se “si” europianët punojnë më pak është

pak se amerikanët është një tjetër. Një pikëpamje është se amerikanët janë perceptuar (dhe i pëlqen ta konsiderojnë veten e tyre), si workaholics kalvinist, ndërsa europianët duan të mendojnë se ata dinë se si të gëzojnë kënaqësitë e jetës. Ama shpjegimi nuk

1973?

Një argument i dytë i atribuohet ndryshimit në taksat e të ardhurave, e cila, në fakt, ka pësuar rritje ndjeshëm në Europë që nga viti 1970, ndërsa në

1980 e më tutje. Tatimet në të ardhura me siguri duhet të ndikojnë në gatishmërinë për të punuar. Ato nuk mund të ndryshojnë shumë numrin e orëve të punës të shtyllës së një familjeje familjes tipike (zakonisht burri), por ata ndikojnë në pjesëmarrjen e grave në fuqinë punëtore. Gjithsesi edhe ky nuk është një shpjegim i mjaftueshëm, sepse studimet sesi oferta e punës i përgjigjet ndryshimeve të taksave sugjerojnë se diçka tjetër duhet të shpjegojë hendekun e madh mes SHBA dhe Europës, në veçanti Francës dhe Gjermanisë.

Për grup-moshën mbi 50, struktura e sistemeve të pensionit është qartazi një faktor i madh. Ka qenë dhe mbetet më e leverdishme dalja në pension më herët në Europë sesa në SHBA.

Në vitet 1980 dhe 1990, shumë sindikata europian të punës, në përgjigje të rritjes së papunësisë, miratuan politikën e “më pak punë, të punojmë

shkurtër (dmth. më shumë pushime) në mënyrë që të mbanin lart punësimin. Problemi është se kompensimi i përgjithshëm nuk është zvogëluar në proporcion me oraret e shkurtuara duke çuar kështu në një rritje të pagës në orë. Produktiviteti i ulët dhe kostot e larta të punës çuan në uljen e

Europën me papunësi kronike më të lartë se sa në SHBA.



Debatet e sotme rreth rritjes ekonomike në Europë

“progresi teknologjik,” dhe “investimi në arsim.” Europeanët sigurisht kanë nevojë për diçka për të kompensuar për një jetë të shkurtër pune me pushime të shumta. Por ky diskutim është më shumë një formë e “korrektësisë politike”, për ti treguar europianëve se rritja është e ngadaltë për shkak se shoqëria nuk është mjaft e bazuar

pushimeve dhe zhvillimit. Europeanët priren të preferojnë pushimet ndaj zhvillimit.

Project Syndicate, qershor 2013

Në pritje të aderimit

Serbia i ofron Malit të Zi përkthime të “Acquis” të BE-së



BalkanInsight ka njoftuar se Serbia do t'i dorëzojë Malit të Zi më shumë se 50,000 faqe të “acquis” të BE-së të përkthyer në gjuhën serbe, me qëllim forcimin e bashkëpunimit mes dy vendeve në rrugëtimin e tyre drejt integritimit europian.

Suzana Grubjesic, zv/kryeministrja serbe për integrimin europian, do të dorëzojë përkthimet e dokumentacionit të BE-së për homologun e saj malazez, Igor Luksic. Acquis konsiderohet legjislacioni i akumuluar, aktet ligjore dhe vendimet e gjykatave që përbëjnë trupin e ligjit të BE-së. Kroacia, e cila do të bashkohet me klubin europian më 1 korrik, i ka ofruar gjithashtu ndihmë Malit të Zi në rrugën e tij drejt anëtarësimit në BE. Vitin e kaluar, dy vendet nënshkruan një marrëveshje reciproke mbi partneritetin Euro-Atlantik, e cila ishte projektuar të ndihmonte qëllimet e Malit të Zi për pranim në BE dhe NATO. Marrëveshja i dha Malit të Zi akses në përkthime kroate të legjislacioneve të BE-së të miratuara që nga viti 2009.

Mali i Zi nisi bisedimet e anëtarësimit me BE-në në qershor 2012. Deri më tani, ai ka mbyllur përkohësisht dy kapituj, 25 dhe 26, mbi Shkencën dhe Kërkimin dhe mbi Arsimin dhe Kulturën. Hapja e kapitujve më sfidues, 23

dhe 24, të cilat fokusohen në forcimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, është ende në pritje. Serbia mori statusin e kandidatit në BE në mars 2012. Më 21 prill, Komisioni European rekomandoi hapjen e negociatave për anëtarësim.

Bashkëpunimi dhe ndihma nga vende që kanë kaluar më parë në procesin e negociatave për anëtarësim në BE mbeten të një rëndësie strategjike. Ndërkohë që vendet fqinje gëzojnë përparësinë e një gjuhe të ngjashme, Shqipëria gjendet disi më e izoluar dhe ende mbetet për tu parë cili vend do të jetë partner dhe “model” për të gjatë aderimit.

Stafi i EuroSpeak, qershor 2013

Raporti i Freedom House 2013 për Shqipërinë, përkeqësim në disa fusha



Për gjashtë vite radhazi,

EMA-s kanë përgatitur raportin mbi Shqipërinë “Nations in Transit” i organizatës Freedom House. Raporti për 2013-

ën me autor Gledis Gjipalin, Drejtor Ekzekutiv i EMA-s, sjell në vëmendje çështjet më të ndjeshme të demokratizimit të vendit. Në këtë raport janë analizuar shtatë pika kryesore si qeverisja qendrore, procesi zgjedhor, shoqëria civile, media, qeverisja vendore, pavarësia juridike dhe korrupsioni. Në lidhje me sistemin e drejtësisë, Freedom House shkruan se institucionet juridike vuajnë nga presione dhe ndërhyrje politike dhe reformat janë të domosdoshme.

Ky raport radhit Shqipërinë në kategorinë e 58 vendeve me liri të pjesshme, që nënkupton

atyre civile. Sylvana Kolezckowa, e organizatës Freedom House, i përshkruan kështu vendet e kësaj kategorie: “Vende me liri të pjesshme janë vendet ku ekzistojnë intitucione demokratike, por ato funksionojnë me të meta të mëdha”. Ajo shton se fakti se Shqipëria vazhdon të ndeshet me pengesa dhe refuzime për anëtarësim në BE, nuk është dhe aq për tu habitur duke pasur parasysh

dobësitë e institucioneve bazë të vendit. Bashkimi European i merr shumë seriozisht çështjet e sistemit gjyqësor, sundimin e ligjit dhe zbatimin e ligjit antikorrupsion.

Krahasuar me një vit më parë, Shqipëria shënon përkeqësim në fusha të ndryshme të qeverisjes, duke arritur në një gjendje të ngjashme me vitin 2003. Sivjet ajo ka marrë notën 3 për dallim nga një vit më parë kur ishte vlerësuar me 3.5. Nga vendet e rajonit, bashkë me Shqipërinë dhe Kosovën, në radhën e vendeve me liri të pjesshme janë edhe Bosnja dhe Maqedonia. Ndërsa, Serbia, Kroacia e Mali i Zi, radhiten në mesin e vendeve të lira.

Stafi i EuroSpeak, korrik 2013

Kufizimi i abortit shkakton protesta në Maqedoni

Duke mbajtur parulla që lexonin “Trupi im, Vendimi im”, dhe “Unë Nuk jam një vrasës fëmijësh”, disa qindra njerëz protestuan para parlamentit maqedonas për t'i bërë thirrje ligjvënësve që të kundërshtonin projekt-ligjin e ri që kufizon abortin.



Nëse ligji miratohet, gratë që kërkojnë abort përtej javës së dhjetë të shtatzënisë duhet të paraqesin një kërkesë me shkrim që duhet të miratohet nga Ministria e Shëndetësisë. Ato duhet të konfirmojnë që morën pjesë në këshillim, informuan të atin e fëmijës për qëllimin e tyre të ndërprerjes së shtatzanisë dhe u takuan me një gjinekolog. Gjithashtu u ndalohet të kryejnë një abort të dytë brenda një viti.

Qeveria e Nikola Gruevskit befasoi shumë më paraqitjen e draftit në parlament nëpërmjet një procedure të shkurtuar. Shumë OJQ kanë reaguar: “Një draft që trajton të drejtat themelore të njeriut nuk duhet të kalojë në një procedurë të shkurtuar. Ndryshimi do të burokratizojë procedurën për gratë dhe vendosë ministrin tërthorazi përgjegjës për vendimet e aborteve. Duhet të lihen mjekët të vendosin mbi këtë çështje, pasi kjo është brenda zonës së tyre të ekspertizës”.

“Rritja e normës së lindjeve duhet të bëhet me stimulues e jo me masa kufizuese. Këto masa na çojnë pas në kohët kur njerëzit e tjerë vendosnin për të drejtat e grave” tha Liljana Poplovska, kreu i partisë së vogël DOM, e vetmja parti e qeverisë që kundërshtoi ligjin. Ministri i Shëndetësisë Nikolla Todorov këmbënguli se ligji i ri nuk e ndalon abortin por vetëm e kufizon në rastet kur shëndeti i gruas kërcënohet. Duke pasur parasysh që në vitin 2009, qeveria nisi një fushatë mediatike kundër abortit, shumë e shohin këtë lëvizje të fundit si një hap drejt një ndalimi të aborteve.

Stafi i EuroSpeak, korrik 2013

BE Ngrin Turqinë deri në Tetor

Bashkimi Europian e ka shtyrë deri në tetor marrjen e vendimit për vazhdimin e bisedimeve të anëtarësimit të Turqisë, si një ndëshkim për mënyrën se si qeveria turke iu është përgjigjur protestave që mbërthyen vendin.

respektimin e të drejtave të njeriut dhe lirinë e fjalës. “Ne jemi një komunitet vlerash” u shpreh më tej ai. “Nuk mund të godasësh ashpër vende jashtë BE-së si Egjipti dhe nga ana tjetër të mos kritikosh një vend kandidat të BE-së.”

Qëndrimi i ngurtë i BE-së e veçanërisht ai i Gjermanisë ndaj Turqisë, ka alarmuar disa vende anëtare, të cilat mendojnë se BE-ja duhet të angazhohet më shumë ndaj Turqisë. Carl Bildt, ministër i Punëve të Jashtme i Suedisë, një mbështetës i zjarrtë i anëtarësimit të Turqisë në BE, u shpreh:

“Bllokimi i ecjes së mëtejshme të Turqisë drejt Bashkimit Europian është një gabim i madh. BE-ja nuk mund të ndryshojë strategjinë e saj në varësi të ngjarjeve që ndodhin në vende të ndryshme.”

Disa vende të tjera, ku përfshihet edhe Britania e Madhe, janë të mendimit se anëtarësimi i Turqisë në BE është kthyer në një çështje politike me ndikim në zgjedhjet parlamentare në Gjermani, të cilat do të zhvillohen në shtator, që i ka dhënë kancelares gjermane Angela Merkel një popullaritet elektoral për shkak të linjës së ashpër ndaj Turqisë.

Rifillimi i bisedimeve në tetor kërkon unanimitetin e të gjitha 28 shteteve anëtare (përfshirë Kroacinë e sapo anëtarësuar) ku çdo vend ka të drejtën e vetos.

Reuters, qershor 2013

